



**VENDIM**

*Nr. 192, Datë 22.12.2016*

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE  
PËR ÇDO NIVEL TENSIONI PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË  
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 21 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 22 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s“, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.12.2016, pasi shqyrtoi, relacionin e Drejtorive Teknike, mbi fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të OSHEE sh.a për rialokim në tarifën për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2017,

**Konstatohet se:**

- Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për rialokim në tarifën për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2017.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

**Vendos:**

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifave për çdo nivel tensioni për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2017.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.